




RAPORTI I PUNËS PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2017





REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL GJAKOVË
SKUPŠTINA OPŠTINE DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Me Udhëzimin Administrativ –MAPL – Nr. 208/02 për themelimin e Njësive për të Drejtat e Njeriut në Komuna, edhe me Statutin Komunal është paraparë themelimi i NJDNJ, si mekanizëm i qëndrueshëm dhe përgjegjës për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivelin komunal, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe politikat e institucioneve të Kosovës. Kjo zyrë, si pjesë e institucionit komunal si fushëveprim të vet ka promovimin e plotë të drejtave të njeriut, barazinë gjinore, mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, PAK dhe të komuniteteve
Aktivitetet e Zyrtares për Barazi Gjinore dhe Mundësi të Barabarta gjatë periudhës Janar-Dhjetor janë të shumta:

Në këtë kuadër, kjo zyrë merret me aktivitetet që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe përkrahjen e të drejtave të grave, fëmijëve dhe dhunën në baza gjinore, në përkrahjen e projekteve të OJQ-ve në promovimin e barazisë gjinore, aktivitetet e grumbullimit të dhënave bazuar në moshë, gjini dhe etni të grupeve (komuniteteve), rastet e dhunës në familje, bashkërendimin e punëve dhe bashkëpunimin e mirëfilltë me të gjitha drejtoritë që prekin në fushën e barazisë gjinore, këshillimin për rastet e grave të ndara nga bashkëshortët, lidhur me përfitimin e ndihmave sociale, krijimin e partneritetit me subjektet relevante në komunë ,etj.

Zyrtarja per Barazi Gjinore në Komunën e Gjakovës konform përgjegjësiqe që ka shfrytëzon të gjithë mekanizmat e mundshëm për të krijuar mundësi për pjesëmarrje aktive të femrave dhe meshkujve në të gjitha fushat e jetës shoqërore, duke u munduar te krijoj nje klime në të cilën atyre ju mundëson të japin kontributin e tyre në të gjitha sferat e jetës shoqerore.ZBGJ ka kryer aktivitete te shumta qe prekin fushen e barazise gjinor

Aktivitet e KNJDNJK-ZBGJ;

Në kuadër të muajit mars muaj i promovimit të drejtave të grave janë zhvilluar këto aktivitete.

Është mbajtur ekspozita nga grat që merren me Art, pikturë, letërsi, fotografi, grim, kreacione mode, pune dore me artizanate të ndryshe, punimin e qirinjëve , ushqim etj;

Është mbajtur një forum diskutimi me këto tema:

A jemi plotësisht të gadshem si shoqëri të përshtatemi me gra të suksesshme?

Cilat janë pengesat që e rëndojnë zhvillimin artistik të gruas, por që nuk është një çështje e vetëbesimit?

- Organizimi i Fushatës një mujore mbi edukimin shëndetësor – riprodhues të grave, nëpër të gjitha qendrat e Mjekësisë Familjare.

Me qëllim të vetëdijesimit të grave për rëndësinë e vizitave dhe kontrollit të tyre në parandalimin e sëmundjeve kancerogjene, si dhe arritja me e lartë e njohurive për evidencimin e sëmundjeve të gjirit dhe bashkëpunimi me institucionet përgjegjëse.

Përfituese direkte nga ky aktivitet kanë qënë 200 gra (10 qendra nga 20 gra).

Organizimi i panarit dy ditor me grate e komunes së Gjakovës të zonave urbane dhe rurale, ku janë prezantuar punimet e grave si me ato me artizanate dhe prodhimin e produkteve ushqimore. Përfituese e këtij panairi kanë qënë 20 gra në formë direkte dhe 20 tjera në formë indirekte .

Me pas unë si ZBGJ-znj.Lumnije Shllaku bera një prezantim mbi historikun e ditës ndërkombëtare të 8 Marsit, ku kam vlerësuar lartë kontributin e femrës përgjatë dekadave.

Zyra për barazi gjinore dhe të drejtat e njeriut në bashkëpunim me shoqatën George Ëilliams Youth Association ka organizuar tryezën e rrumbullakët në kuadër të aktiviteteve të muajit mars me moton *“Muaji i promovimit të drejtave të grave”*.

-Janë mbajtur 8 takime të rregullta me GGA , dhe 10 takime me OJQ-te lokale me qëllim të përkrahjes dhe avancimit të gruas në të gjitha sferat si shoqërore ashtu dhe politike. Qëllimi i takimeve ishte identifikimi i nevojave dhe problemeve të këtij komuniteti.

Me datën 22 shkurt 2017, është organizuar një vizitë një-ditore e grave që përfaqësojnë komunitete të ndryshme fetare, zyrtarë komunal për barazi gjinore, përfaqësues të organizatave joqeveritare që merren me të drejtat e njeriut dhe të drejtat e grave, nga komunat e Pejës, Gjakovës dhe Istogut, në objektet fetare në komunën e Gjakovës. Vizitat që u ndërmorren gjatë këtij aktiviteti, ishin vizita në Xhaminë e “Hadumit” në Çarshinë e Vjetër, Kishën Katolike “Shën Pjetrit dhe Shën Palit”, Kishën Ortodokse “Zonja e Bekuar”, Teqen e “Sheh Eminit”, Teqen e Bektashinjëve dhe në Bshkësinë E Zotit Jezus” në Gjakovë. Ky aktivitet është lehtësuar nga OSBE Misioni në Kosovë.

Gjatë këtij aktiviteti patëm mundësi të njihemi mes veti, me diversitetin kulturor dhe fetar, me organizimin e brendshëm të komuniteteve të ndryshme fetare, kyqjen e grave

dhe te rinjeve ne takimet e ndryshme, luftimin e fenomeneve negative si luftimin e ekstremitetit fetar dhe jotolerances, si dhe të diskutojnë për tema të ndryshme lidhur me rolin e gruas ne promovimin e dialogut ndërfaqetare si dhe çështje që preokupojnë keto komunitete.

Rekomandimet e dalura nga ky aktivitet:

- Forcimi i bashkëpunimit në mes grave që përfaqësojnë religjione të ndryshme si dhe komunitetin lokal, përmes aktiviteteve të ndryshme;
- Përfshirja në vizita tentative në vende të tjera fetare si psh: Manastiri i Deçanit dhe komunitetit hebre, duke përfshirë më shumë gra nga rajoni;
- Ofrimi i ligjeratave të përbashkëta mbi promovimin e dialogut ndërfaqetare, tolerancës fetare dhe mirëkuptimit, si dhe mbi luftimin e ekstremitetit të dhunshëm;
- Pjesëmarrja në takime të ndryshme të organizuara nga zyrtarët komunalë për barazi gjinore, promovimit të dialogut ndërfaqetare dhe luftimin e ekstremitetit të dhunshëm;
- Sigurimin e mbështetjes nga donatorët potencial apo mbështetjen komunale rreth organizimit të aktiviteteve të ngjashme në rajon;
- Organizimin e radio debateve me gratë që përfaqësojnë komunitetet e ndryshme fetare mbi vlerat e përbashkëta të feve;
- Krijimi një listë të kontakteve dhe një dosje me fotografi te vizitave te realizuara, si dhe shtimin e pjesëmarrësve në grupin ekzistues të mbyllura në rrjetin social "Facebook";
- Ndarja këtyre rekomandimeve me zyrtar relevant komunal (kontakt personi komunal për çështjet e komuniteteve fetare, zyrtar për barazi gjinore, etj).

*Takimin e rregullte koordinues me grupet e interesit dhe komunitetin, te organizuar ne bashkëpunim me shoqaten "Handikos" (Qendra e rehabilitimit te bazuar ne bashkësi).

-Prezantimi i projektit" Shërbimet e bazuara ne komunitet per fëmijët me aftësi te kufizuar te financuar nga Save dhe Children/MACF.

Takimin e organizuar nga shoqata Medika Kosova, me temën "Përkrahja e grave kryefamiljare të dëmtuara nga lufta për t'ju qasur subvencioneve komunale në bujqësi" financuar nga Fondi i Grave të Kosovës (FGK), në kuadër të Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK).

Medica Kosova na njoftoj se gjate realizimit te projektit ka zhvilluar 40 trajnime per gra lidhur me analizen e programit të subvencioneve, kriteret e aplikimit dhe qasjen në informata përmes internetit. Pjesëmarrëse gjate takimit ishin edhe gra kryefamiljare te zonave rurale te komunës se Gjakoves.



-Organizimi i aktivitetit ne kuadër te shënimit te “Ditës se Tokës “me 22 prill, ne bashkëpunim me GGA dhe kabineti I Kryetares.

Ky aktivitet është shënuar me qëllim sensibilizim dhe edukimit për ruajtjen dhe zhvillimin e mjedisit jetësor, dhe për qëllim te vetëdijesimit te komunitetit për ruajtjen e ambientit.

Organizimi i një tryeze ne bashkëpunim me shoqatën e te Verbërve te Kosovës me temën ‘E drejta per qasje te lire’. Qëllimi i kesaj tryeze avokim para institucioneve komunale per krijimin e kushteteve per qasje te lire” semaforët akustik”. Pjesëmarrës ne tyres ishte Kryetarja e komunes , drejtoresha e arsimit,drejtori i shendetesise, udheheqesi i sektorit te komunikacionit, koordinatorja per te drejtat e njeriutdhe barazi gjinore, personat me te pamurit te dobesuar etj.

*Marrja pjese ne Konferencen mbi praktikat e mire te mekanizimit koordinues te shtate komunave te kosoves ne kuader te projektit te Agjencioneve te kombeve te Bashkuara per luftimin e dhunes ne familje, njeherit ishte kenaqesi per mekanizimin e komunes se Gjakoves qe pati çfare te prezantoj te arriturat dhe instiucionalizimin e tij Punetoria eshte mbajtur ne Oher, dhe eshte perkrahur nga UN Women.



Momente të shkptura nga punetoria tri ditore ne Oher.

Marrja pjesë në Komisionin për ndarje te grandeve për rini, si komision kemi përgatitur dokumentet per fillimin e proceseve ne ndarje të grandeve për rini; Thirrje për aplikim, Flete aplikacionin, dhe raportin final.

-Marrja pjesë ne aktivitetet në kuadër te ditës ndërkombëtare te fëmijëve 1 Qeshori , shoqata HandiKos së bashku me prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuar, Drejtorin e Arsimit, shkollën fillore "Mustafa Bakija", qendrën inovative "Bone Vet" ka organizuar disa aktivitete që kanë për qëllim promovimin e të drejtave të fëmijëve, sensibilizimin e shoqërisë mbi pozitën e fëmijëve me aftësi të kufizuar si dhe socializmin e fëmijëve me aftësi të kufizuar në shoqëri.

Pjesëmarrje në tryezën "Fushatën Promovuese për Ndihme Juridike Falas të organizuar nga Agjencia e Kombeve te Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe Ambasada Norvegjeze në Kosovë.

Organizimi i një tryeze ne bashkëpunim me shoqatën e te Verbërve te Kosovës me temën "E drejta per qasje te lire".

Marrja pjese në Konferencën dy ditore te organizuar nga shoqata Medika Gjakova me temën "Fuqizo gruan tani".

-Përkrahja rreth organizimit te panairit dy ditor te pazari (afër Çabratit) me ekspozimin e punimeve te grave dhe produkteve ushqimore ne kuadër te festifalit "Spark Holistic".

*Organizimi i tryezës" Promovimi i dhurimit të gjakut" në bashkëpunim me GGA në kuadër të fushatës të muajit qershor muaj i dhurimit të gjakut.

* Marrja pjesë në hartimin e Rregullores për mbrojtjen e femijeve nga dukuritë negative si dhe në Rregulloren për mbrojtjen e femijeve në kuadër të programit " Gjakoja mike për femijet".

Gjatë periudhës janar –dhjetor janë zhvilluar 8 takime me GGA dhe 10 takime me shoqërinë civile me qëllim të promovimit të drejtave të njeriut në fokus të drejtave të grave. Qëllimi i takimeve ishte identifikimi i nevojave dhe problemeve të këtij komuniteti.

Takime të rregullta me GGA me qëllim të përkrahjes dhe avancimit të gruas në të gjitha sferat si shoqërore ashtu dhe politike.

Zyrtarja për barazi gjinore në bashkëpunim me Grupin e Grave asambleiste ka organizuar një tryezë në kuadër të shënimit të ditës ndërkombëtare të 1 Majit, me temën "Papunësia e të rinjve".

Pjesëmarrës gjatë tryezës ishin anëtarët e GGA, përfaqësuesja e YMCA- Dorina Lluka, dhe të rinjtë e komunës së Gjakovës.



Marrja pjesë në tryezën e rrumbullakët me temë "**Krijimit të hapësirave të sigurta për të rinjtë nga komunitetet pakicë dhe atyre me nevoja të veçanta**" të organizuar nga shoqata GWYYMCA në Gjakovë. Gjatë tryezës u nxuarrën rekomandimet me qëllim të përmisimit të gjendjes së rinjeve të komunitetit pakicë dhe atyre me nevoja të veçanta. Pjesëmarrës në tryezë ishin përfaqësues të shoqatave me nevoja të veçanta, të rinjtë nga komuniteti pakicë, përfaqësues të institucioneve.



*Marrja pjesë ne debatin “ Si parashihet fuqizimi i pozitës se gruas ne programet e partive politike-Një shans per gruan”. Ne panel ishin kandidatet e komunës se Gjakovës per deputete te Kosovës. Si ZBG J, ju perkujtova kandidateve per deputete se në fushatën elektorale për zgjedhje të parakohshme parlamentare të 11-të qershorit 2017, respektimin dhe zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore të Kosovës, gjithashtu kerkova nese zgjedhen deputete te Paralamentit te Kosoves te jene zeri I grave ne paralament ne zbatimin e ligjeve te miratura dhe harmonizimin e ligjeve.

*Marrja pjese ne tryezën e rrumbullaket ne Publikimin e Katalogut per Këshilla dhe ndihme per Viktimat e Krimit” te organizuar nga OSBE-ja. Pjesëmarrës ne tryeze ishin gjykatës te Gjykatës Themelore ne Gjakove , Prokurorisë Themelore ne Gjakove, Gjykatësja nga Forumi i Grave te Gjykatave ne Kosove ,përfaqësues te institucioneve qe merren me mbrojtjen e te drejtave te njeriut, etj.

Qëllimi i këtij katalogu është qe te ofroje një harte per viktimat e krimit nga rajoni i Gjakovës, me qellim te sigurimit te drejtave te tyre, duke ju mundësuar qasje me te lehte dhe me te kuptueshme rreth ekzistimit te mekanizmave ligjore dhe institucionale ne dispozicion ne fushën e te drejtave te viktimave te krimit.



Momente te shkëputura nga tryeza e rrumbullakët në Publikimin e Katalogut për Këshilla dhe ndihmë për Viktimat e Krimit”.

Marrja pjesë në **Lancimi e komentarit të Ligjit për Barazi Gjinore, të organizuar nga Agjencioni për barazi gjinore pranë zyrës së Kryeministrit**. Qëllimi I këtij komentari ishte lehtësimi, sqarime dhe përshpejtim të proceseve të avancimit dhe të zbatimit të drejtësisë të arritjes së barazisë gjinore dhe marrjes së vendimeve adekuate nga ana e institucioneve relevante në frymën e parimeve themelore të drejtave të njeriut, parim ky i paraparë edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Hapjen e takimit e bëri Kryeministri I Republikës së Kosovës Z.Ramush Haradinaj, pjesëmarrës në takim ishin përfaqësues të Gjykatave të Kosovës nga të gjitha nivelet, Prokurorë të të gjitha niveleve, institucionet tjera qeveritare, OJQ vendore dhe Organizata Ndërkombëtare, zyrtare për barazi gjinore në ministri dhe në komuna.

Marrja pjesë në trajnim një ditore për zyrtarët për barazi gjinore me temën “Vlerësimi I dëmve pas Fatkeqësisë” të organizuar nga Agjencioni për barazi gjinore në perkrahje të UNDP-se. Si rekomandim I këtij trajnimi dual se komunat duhen të pregadisnin Planin operativ emergjent për vlerësimin e dëmeve nga ftekeqesitë natyrore dhe ftekeqesitë tjera, me statistika të ndara sipas gjinisë, etnise dhe grup moshave.

Përfaqësuesi i grupit të Rrjetit të Grave të Kosovës, zhvilloi një intervistë gjysmë ore me ZBGJ -Znj.Lumnije Shllaku, lidhur me zbatueshmërinë e Strategjisë Kombëtare Kundër Dhunës në Familje në Kosovës, se sa është duke u zbatuar në komunën e Gjakovës. Si koordinatorë e mekanizimit kundër dhunës në familje bëra prezantimin lidhur me implementimin e strategjisë dhe planin e veprimit kundër dhunës në familje në komunën e Gjakovës, institucionalizimin e MKDHF ,si dhe të arriturat e këtij mekanizimi.

Marrja pjesë në të gjitha takimet e Këshillit për Siguri në Bashkësi

Marrja pjesë në përpilimin , hartimin e thirrjeve për aplikim për ndarje të subvencioneve për shoqatat e komunës së Gjakovës të cilat ofrojnë shërbime sociale dhe strehim të viktimave të dhunës në familje, duke iu referuar Rregullores MF -Nr.04/2017 mbi kriteret ,standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Në bashkëpunim me përfaqësuesit e zyrës së OSBE-se së komunës së Prizrenit është mbajtur takimi me disa anëtarë të Mekanizimit kundër dhunës në familje të komunës së Gjakovës. Takimi është mbajtur në sallën e asamblesë komunale të Gjakovës, prezent në takim ishin ; Mbrojtësi i viktimave të dhunës në familje, drejtoresha e Shtëpisë së Sigurte, drejtori i Qendrës për Punë Sociale , përfaqësues të Policisë dhe Zyrtarja për barazi gjinore(Koordinatorë e MKDHF).

Qëllimi i takimit ishte përpilimi i ftesës dhe agjendës së takimit të ardhshëm mes MKDHF të tri komunave; Gjakovës, Rahovecit dhe të Malishevës

Qëllimi i takimit është shkëmbimi i përvojave ne mes tri komunave dhe nxërja e rekomandimeve ne përmasimin e shërbimeve te gjithë aktereve ne përkrahje te viktimave kundër dhunës ne familje.

Marrja pjese ne nëntë (9) takime te aktereve lokal te komunës se Gjakovës ne projektin YES te financuar nga GIZI.

Qëllimi i takimit sfidat dhe mundësit qe përballen personat e riadhesuar ne Komunën e Gjakovës. Ne këtë takim u diskutua rreth mundësisë qe mund ti ofrojnë strukturat lokale per ritregimin te qëndrueshëm te riadhesuarve ne tregun e punës.

Marrja pjese ne tryezën me temën “Agjendat e barazisë gjinore ne demokracinë lokale e organizuar nga Rrjeti i Grave “Qeliza” ne Gjakovë. Qëllimi i takimit ishte prezantimi i përfaqësuesve te partive politike, këshilltareve komunal, ne arritjen e barazisë gjinore ne komunë, problemet qe i kane identifikuar para dhe gjate kandidimit si dhe si do te angazhohen ne përmasimin e gjendjes se punësimit, arsimit, shëndetësisë, kulturës etj.

Implementimi I aktivitetit ne kuadër te fushatës kundër kancerit te gjirit te organizuar nga Zyrtarja per barazi gjinore Znj.Lumnije Shllakune bashkepunim me GGA she OJQ-Medika Gjakove”. Qëllimi i tryezës ishte informimi dhe te vetëdijesimit i grave për rrezikun nga sëmundja e kancerit të gjirit dhe për gjetjen e mundësive për zbulimin e hershëm.

Hapjen e beri zyrtarja per barazi gjinore, ndërsa dok. Merita Rruka informoi te pranishmit per trajtimin e kancerit te gjirit dhe pasojat qe i krijon kjo sëmundje, ne theks te veçantë ne parandalimin dhe gjetjen e mundësive per zbulimin e hershem te kancerit te gjirit mes te tjersh theksoj se Mamogramet e rregullta zvogëlojnë numrin e vdekjeve nga kanceri i gjirit .

Po ashtu ne panel ishte e pranishme edhe motra medicinale e cila punon ne ambulancën ku behet falas incizimi i gjirit(Mamografise), ku njeherit informoj per rëndësinë e mamografise e cila qëndron ne mundësinë e zbulimit te hershem te ndryshimeve ne indet e gjirit.



Përgatitje rreth organizimit të aktivitetit punësim dy ditor të personave me aftësi të kufizuar në kuadër të muajit Tetor Muaji i mundësive të barabarta profesionale të PAK. Meqenëse të gjitha përgatitjet u bënë në kohë të caktuar, ky projekt nuk u realizua këtë vit, në pamundësinë e mbështetjes financiare, edhe pse ka qenë e miratur nga bordi i drejtoreve.

Marrja pjesë në punëtorinë dy ditore në Pejë të organizuar nga OSBE me temën 'Përpyqje të përbashkëta drejt integritit të buxhetit të përgjithshëm gjinor në buxhetet komunale. Pjesëmarrës të punëtorisë ishin; përfaqësues të Ministrisë së Financave, përfaqësues të MAPL, Zyrtarët për barazi gjinore të shtatë komunave dhe të OSBE-se.



Marrja pjesë në tryezën e organizuar nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore me temën "Përfaqësimi gjinor në shoqëri". Gjate këtij takimi u diskutua për të drejtat e grave në sektorin privat dhe në shoqërinë civile. Pjesëmarrës gjate takimit ishin përfaqësues të shoqërisë civile, institucioneve dhe sektorit privat.

Organizimi i një tryeze ndërkomunale për të diskutuar mbi Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2016-2020 (Strategjia), në bashkëpunim me zyrën e OSBE-se të Prizrenit.

Qëllimi i tryezës së rrumbullakët ishte paraqitja e Strategjise, ku është diskutuar lidhur me hapat dhe mënyrat për ta rritur zbatimin efektiv të saj në nivel lokal. Gjithashtu, është diskutuar lidhur me dispozitat e reja në kuadër të Strategjisë dhe është theksuar tendencat dhe sfidat e nivelit lokal nga hisedarët në zbatim të Procedurave Standarde të Veprimit për viktimat e dhunës në familje.

Si koordinatorë e mekanizimit bera prezemin mbi themelimin e mekanizimit si dhe të arriturrat dhe sfidat e mekanizimit kundër dhunës në familje.

Pjesëmarrës në tryezë ishin; përfaqësues të OSBE-se të nivelit qendror të tri komunave, Gjakovës, Rahovecit dhe Malishevës, Zv. Ministri i drejtësisë Z. Munir Basha, përfaqësues të QPS të tri komunave, Prokurorja Znj. Shpresa Bakija, mbrojtësi i

viktimave, përfaqësues të Shoqatave që merren me përkrahje të viktimave kundër dhunës në familje, përfaqësues të drejtorive të arsimit dhe të shëndetësisë, etj..foto



Organizimi i një punëtorie në bashkëpunim me Shoqatën e të Verbërve të Kosovës mbi rëndësinë e implementimit të ligjit për personat e të verbërve Nr. 04/L-092 dhe nxërja e një Rregulloreje që ju mundëson të gjithë personave të verbër, përfitues të këtij ligji të lirohen nga taksat dhe tatimi që parashihet në nenin 6 të këtij Ligji. Pjesëmarrës në punëtori ishte vetëm ushtruesja e detyrës së drejtorisë së punëve të përgjithshme Znj. Erlinda Rizvanolli, ku ishin të ftuar të gjithë drejtorët e drejtorive. Si koordinatorë e NJDNJK-BGJ isha në cilësinë e panelistes, ku bëra një prezantim lidhur me respektimin e të drejtave të personave të verbër të garantuara me ligjin për të verbër, si dhe ligjeve tjera të miratuara në Kuvendin e Kosovës. Drejtori i Shoqatës së të verbërve të Kosovës, e prezantoi Ligjin për të verbër nën nën, ku mes të tjerash u diskutua lidhur me zbatueshmërinë e nenit 6 të këtij ligji dhe me harmonizimin e ligjeve të miratuara në Kosovës. Drejtori i shoqatës së të verbërve e përmbylli takimin me thënë të një filozofi francez; personat me aftësi të kufizuara i ka nda në tri kategori; me aftësi të kufizuara mendore, fizike dhe kategorinë e tretë personat që nuk i shohin dy grupet e para.?

Marrja pjesë në ceremoninë përmbyllëse të OJQ GWY të projektit „dy vjeçar“ „Creating Safe Space for Young People“, Programi i Liderimit dhe programi i Barazisë Gjinore - Y WoMan në Komunën e Gjakovës, ku u prezantuan rezultatet dhe të arriturat e këtij projekti.

Marrja pjesë në punëtorinë njëditore në Prishtinë e organizuar nga USAID për **Zyrtarët dhe Zyrtarët për Barazi Gjinore (ZBGJ-të)** në Komuna. Qëllimi i kësaj punëtorie ishte që të informoj ZBGJ-të me sfidat praktike dhe politike me të cilat ballafaqohet sektori i pronave në Kosovë dhe masat dhe reformat e propozuara në Strategjinë Kombëtare për të Drejtat Pronësore. Më specifikisht, në këtë punëtori u diskutua lidhur me masat që Strategjia Kombëtare sygjeron për të adresuar sfidat me të cilat përballen gratë në ushtrimin e të drejtave të tyre pronësore.



Ne komunën e Gjakoves numri i femrave ne pozitat menaxheriale ka qene I kenaqeshem, ku ne poziten menaxhuese te komunës ka qene Kryetare Znj. Mimoza Kusari Lila , prej 12 drejtorive 4 drejtori i menaxhojnë femra (4 drejtoresha),dhe 2 ushtruese te detyres se 2drejtorive. Ne pozita udhëheqëse ne sektor te ndryshëm ne administrat kemi 7 femra, ne arsim 7 drejtoresha te shkollave dhe 1 zv. drejtoresh, ne shëndetësi numri i femrave ne pozita menaxheriale është 26.

Numri total i përfaqësimit te femrave ne administrat ne komunën e Gjakoves per periudhen janar-dhjetor 2017 ka qene 74 prej 268. Ne asamblen komunale prej 35 keshilltareve,ku prej tyre 12 femra. Numri total i përfaqësimit te grave ne Kuvendin Komunal te Gjakoves është është 1190(Arsimi, Shendetesia , administrata ne komune, asambleistet.

*Marrja pjesë në tryezën e organizuar nga Ministria e Punëve te Mbrendshme- Koordinatori Nacional Kundër Trafikimit me Njerëz me temen: Parandalo dhe fuqizo ;Adresimin e Trafikimit me Qenje Njerzore ne nivel local. Tryeza u zhvillua ne objektin e shkollës së gjimnazit ‘Hajdar Dush’I në Gjakovë. Pjesëmarrës në këtë tryeze ishin;Z. Naim Muja – drejtor I strategjive/ Ministrine e Punëve te Mbrendshme, Z.Bedri Cahani, Koordinator I Ekipit Veprues per Siguri ne Bashkesi, Nen koloneli Z. Fehmi Xhata- drejtori DHTQNJ-Policia e Kosoveë, Z. Hasan Pruthi -Prokuror, Z. Basri Kastrati – drejtor I ZMNV/ Mrojtesi I viktimave, Komandati I Stacionit Policor- Z. Major Krist Gjokaj, Znj. Lumnije Shllaku- Koordinate e Njesit te Drejtave te Njeriut, Z.Gjon Luli – drejtor I QPS , përfaqësues te grupit rinor dhe nxënës te gjimnazit “Hajdar Dushi”.Qëllimi I kësaj tryeze ishte vetedijesimi ne parandalimi dhe luftimi I trafikimit me qenje njerezore tek qytetaret e komunes se Gjakovs ne theks te veqante tek te rinjet.

Në kuadër të fushatës globale “16 DITET E AKTIVIZIMIT KUNDËR DHUNËS NË BAZA GJINORE”, mekanizmi koordinues kundër dhunës në familje ka zhvilluar takime me qëllim të ngritjes së vetëdijes tek banoret e komunës së Gjakovës. Aktivitetet janë realizuar përmes udhëheqjes së koordinatores së MKDHF me përkrahjen e anëtarëve të mekanizmit kundër dhunës në familje, (drejtoris për administratë të përgjithshme, drejtoris së arsimit me drejtorat e shkollave fillore të mesme të ulët dhe të larta, zyres për komunitete, drejtoris për shëndetësi, , qendres për punë sociale, gjykatës themelore, prokurorisë së shtetit, Policisë, mbrojtësit të viktimave, spitalit rajonal “Isa Grezda”, qendres për ndermjetësim, zyres për ndihmë juridike falas . Mekanizmi është përkrahur edhe nga shoqatat/OJQ-te në realizimin e sukseshëm: “Shtëpia e sigurt”, “Femrat Aktive të Gjakovës”, “Shoqata për edukim dhe perkujdesjen e familjes”, “Medica Kosova”, “Caritas Kosova”, Medika Kosova, Medika Gjakova, , Rrjeti Qeliza, dhe TV Syri vision.



Kjo fushatë është përkrahur financiarisht nga Komuna e Gjakovës, OSBE Misioni në Kosovë, dhe UNWOMAN.

Anëtarët e MKDHF në K.Gjakovës kanë implementuar vazhdimësinë e aktiviteteve ndërgjegjëse kundër dhunës në familje, respektivisht të komponentes të ligjerimit në këtë temë në SHFMU-te Komunës së Gjakovës, në periudhën kohore **27.11-04.12.2017**. është i mbështetur financiarisht nga UNWOMEN dhe Komuna e Gjakovës.

Me rastin e 25 Nëntorit Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas, Zyrtarja për Barazi Gjinore –Mekanizmi kundër dhunës në familje, me qëllim të shënimit të kësaj date dhe 16 ditëve të aktivizmit, ka organizuar aktivitete të ndryshme, ndër të tjerash edhe marshimin me moton “Te mos lëmë askënd prapa: Ndal dhunën ndaj grave dhe vajzave”, që njeherit ka qenë aktivitet nismëtar i fushatës që ka për

qellim ta ngris vetëdijen ne komunitetin e gjere ndaj dhunës ne familje, vendpunim e kudo me mesazhin qe ky problem i përket te gjithëve jo vetëm grave. Ecja ka filluar nga pallati i kulturës “Asim Vokshi” dhe ka vazhduar deri ne Qarshine e vogel dhe anasjelltas.



Hapja e fushatës dhe shenimi i dites nderkombetare per eliminimin e dhunës ndaj gruas

Marshuta është organizuar nga pallati “Asim Vokshi” deri te Qarshia e vogël. Aktiviteti është koordinuar nga anëtarët e mekanizmit koordinues kunder dhunes ne familje (MKKDhF) dhe shoqërisë civile-Rrjeti “Qeliza” ne Gjakovë

Shtate(7) takime senzibilizuese ;ne fshatin. Ponoshec,fsh.Demjan, fsh.Gerqine, fs.Guske, Ali Ibra, SHFMU “ Zekria Rexha” dhe SHFMU” Mustafa Bakija”.



Shpërndarja e këtyre materialeve është bërë me mbështetjen e OJQ-ve gjatë takimeve të ndryshme sensibilizuese që ato kanë organizuar, si edhe nëpërmjet institucioneve arsimore (kryesisht shkollave) përmes nxënësve. Një pjesë e materialeve janë shpërndar edhe nëpërmjet qendrave shëndetësore të mjekësisë familjare.

Në kuadër të ndërgjegjësimit të komunitetit, bazuar edhe në planifikimin e bërë në Planin Strategjik të Komunës, gjatë zbatimit të këtij projekti janë realizuar disa takime informuese me nxënësit e shkollave. Organizimi i këtyre takimeve është bazuar në Marrëveshjen e Mirëkuptimit të nënshkruar mes antarëve të Mekanizimit Koordinues, për realizimin e të cilave janë angazhuar përfaqësues nga të gjitha institucionet antare. Në takime informuese kanë marr pjesë mbi 400 përfitues direkt. Ndërsa në mënyrë indirekte, popullata në masë është informuar përmes fletushkave, posterave dhe mjeteve të informimit, mbulueshmëria nga TV Syri Vision.

Në vijim të aktiviteteve ndërgjegjëse, në kuadër të Fushatës së 16 Ditëve, Komuna Gjakovës (MKDHF) në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimit dhe bibliotekën e qytetit "Ibrahim Rugova", ka **organizuar hapjen e një ekspozite** dhe ka shpallur konkursin për punimin më të mirë për punimet (vizatimet) që janë përzgjidhur në kuadër të fushatës.

Konkursi është shpallur në shkollat e mesme të komunës (gjimnazit "Hajdar Dushi", shkollën teknike "Nexhmedin Nixha", shkollën fillore në Brekoc-Zef L. Marku) fituesit e tre cmimeve (tretë, dytë dhe parë) në një ceremoni që është organizuar në bibliotekën e qytetit "Ibrahim Rugova".



Me 11 .dhjetor është përmbyllur fushata në ditën ndërkombëtare të drejtave të njeriut me një tryeze të rrumbullaket me Persona me nevoja të veçanta, me gra dhe vajza të komunitetit rom ,egjiptian dhe ashkali, lidhur me dhunën në familje dhe të drejtat e gruas në Kosovë. Pjesëmarrës në tryezë ishin anëtarët e mekanizimit kundër dhunës në familje, shoqëria civile etj. Qëllimi i tryezës ishte që të ngrise vetedijen, njohuritë dhe informata tek qytetarët duke synuar të zvoglohet numri i rasteve të dhunës në familje, promovimi i barazisë gjinore,

Përfitues dhe pjesëmarrës të kësaj tryeze janë anëtarët e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian, personat me aftësi të kufizuara, gratë dhe vajzat nga vendbanimet e ndryshme të komunës.

Rekomandimet nga Tryeza e rrumbullaket "Të gjithë së bashku kundër dhunës në baza gjinore dhe diskriminimit", të mbajtur nga MKDHF në Gjakovë me dt. 11. 12.2017.

1. Ristrukturimi i mekanizimit kundër dhunës në familje në komunën e Gjakovës.
2. Rishikimi i Memorandumit të Mirëkuptimit
3. Rishikimi i planit të veprimit
4. Te zhvillohen aktivitete ndërgjegjësuese kundër dhunës në familje çdo muaj, respektivisht të komponentës të ligjërimit në këtë temë në SHFMU-te Komunës së Gjakovës.



Gjate periudhës janar-dhjetor 2017 janë zhvilluar 12 takime me anëtarët e Mekanizimit Kunder Dhunes në Familje .

Sipas të dhënave nga Shtëpia e Sigurte

Viti 2017=35 kliente –gra të Gjakovës (nga numri i përgjithshëm 63 kliente, duke i përfshirë edhe fëmijet)

Sipas të dhënave nga Stacioni Policor i Gjakovës

Viti 2017 – 57 raste të dhunës në familje.

Si ZBGJ kam marrë pjesë në të gjitha panelet e intervistimit të shërbyesve civilë deri në shtator të vitit 2017, sipas konkurseve të shpallura për punësim, duke u përkujdesur që gjatë procedurave të mos cenohet, por të respektohet barazia gjinore, trajtim të barabartë në kontekst të zbatimit të drejtave të njeriut . Gjithesë gjatë periudhës janar-shtator kam marrë pjesë në 6 komisione për intervistime të kandidatëve në bazë të konkurseve për plotësimin e vendeve të punës, dhe në 4 komisione për staf teknik

